



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izhorni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.929/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Ferki Xhaferi kryesuese, Rustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Deçanit, Gazmend Zajmi nga Subjekti Politik Levizja Vetevendosje, me seli në Prishtinë paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 06.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet i pabazuar apeli Anr.929/2021 i datës 04.11.2021, paraqitur nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Deçanit Gazmend Zajmi nga Subjekti Politik Levizja Vetevendosje, me seli në Prishtinë.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Deçanit Gazmend Zajmi nga Subjekti Politik Levizja Vetevendosje, me seli në Prishtinë, në të cilën kërkon rinumërimin e votave në vendvotimin në tersi në komunën e Deçanit. Si prove ka bashkangjitur disa mesazhe në rrjetin social në facebook. Pretendon në mundësi potenciale të manipulimit me vota me bartje në FRK, por që dëshmi nuk ka mundur të siguroj, për shkak se nuk mund të u kërkoj dokumente për provë votuesve pasi është jo etike.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pa bazuar


Nga shkresat e lëndës, rezulton se kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Deçanit Gazmend Zajmi nga Subjekti Politik Levizja Vetevendosje, me seli në Prishtinë, ka parashtruar apel ku ka kërkuar nga PZAP-i, që të bëhet rinumërimi në tersi të votave në komunën e Deçanit për shkak të mundësisë së manipulimit me vota gjatë bartjes në FRK.

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse lidhur me shkeljet e supozuara për mospërputhje të rezultateve, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret paneli, nuk mundi të konstatoj se ka pasur manipulime gjatë numërimit të votave për

kandidat të këtij subjekti politik, ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete por janë supozime sepse pritjet e ankuesit për të marrë më shumë vota automatikisht nuk nënkupton se ka mospërputhje të rezultatit si dhe llogaritja matematikore nga ana e ankuesit nuk argumenton shkeljet e pretenduara në apel.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësa
Anr.929/2021 më datën 06.11.2021**



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.